


# Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

## Odeljenje za Zaštitu i Spašavanje

### Department of Protection and Rescue




## MBROJTJA NGA ZJARRI

Shpëtimi i jetës dhe i pasurisë

Qytetarë të ndërtuar

Stina e verës sjell temperatura të larta të ajrit, të cilat e shtojnë rrezikun për shfaqjen e zjarreve në zonat malore, fushore si dhe në vendbanime. Duke pasur parasysh pasojat e katastrofave që mund të vijnë nga shpërthimet e zjarreve, përfshirë edhe jetën e njerëzve.



## APELOJMË

Të jemi të kujdesshëm dhe vigjilent për shmangjen e gjithë shkaktarëve të mundshëm të zjarrit. Zjarri mund të shkaktohet me një fije shkrepese, por nuk mund të shuhet me ekipe të tera të zjarfikësve, përdorja e pasojat mund të jenë të pa parashikueshme. Vezhimi i ajërimit dhe alarmimi me koha i shfaqjes së zjarrit do të mundësojë intervenimin e shpejtë dhe efikas të Shërbimeve Zjarfikëse dhe ekipeve të shpëtimit në lokalitimin dhe shuarjen e zjarrit. Si duhet të veprimi në rast zjarri:

• Qëndro i qetë dhe mos bë panik!

• Thirr numrin 112 dhe lajmëro zjarin ( prezantohu, trego vendin e saktë, adresën dhe ndërtidhe atë me ndonjë objekt të randësishëm, mbaje linjën telefonike të lire). Nëse zjarri është në fazën fillestare provo të e shuash duke përdorur batanije, shtroje, ujë, rërë apo aparatën për fije të zjarrit. Zjarret e shkaktuara nga rryma nuk guxojnë të shuhen me ujë. Këto zjarre shuhen me anë të aparateve për fije të zjarrit të mbushura me CO2.

• Shkyçje ndërprerësin kryesorë nëse mund ti qasesh!

• Nëse zjarri përfshin rrobat e trupit atëherë mbuloju me një batanije ose shtrihu në dysheme dhe rrokullisu.

• Në rast të shfaqjes së tymit qëndro në shtëpi dhe përdore gjëra të lagura, imbyllji të gjitha të çarat, vrimat nga mund të hyjë tymi në dhomë.

• Qëndro sa më poshtë që mundesh, nëse është e nevojshme shtrihu në dysheme që të ikësh tymit

• Kur të arrijnë zjarfikësit sinjalizoi për vendndodhjen tënde.

• Gjatë gjithë kohës qëndro në linjë telefonike me numrin emergjent 112.

### Informimin mund ta bëni në:

• Qendrën e Alarmimit nëpërmjet numrit të integruar emergjent – 112. Numrin emergjent 112 mund ta thirrni dhe ta merrni pa prefix, nga çdo vend apo pozitë ( tunele, puse, podrumë, humnera, etj) në Republikën e Kosovës.

• Shërbimin për Zjarfikës dhe Shpëtim mund ta merrni në numrin fiks 93, ndërsa me telefon celular prej VALES 193 dhe prej telefonit celular të IPKO-s 933.

• Policinë e Kosovës mund ta merrni në numrin e telefonit fiks 92 dhe 192 në telefonin celular.

• Ndimën e shpejt mjekësore mund ta merrni në numrin e telefonit fiks 94, e celulare prej VALES 194 dhe IPKO-s 944.

Të gjitha thirrjet telefonike emergjente në numrin fiks dhe celulare janë falas.

Ligji për Mbrojtje nga Zjarri nr. 04/L -027 i obligon të gjithë qytetarët që të ndërmarrin të gjitha masat për mbrojtje nga Zjarri.